



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 365/2021

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar
Anila Malaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 14.07.2021 shqyrtoi ankesën përkatësisht me:

- Objekt:** Shfuqizim i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave në lidhje me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-90596-03-19-2021, me objekt: Loti I “Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues”, me fond limit 125,924,225.74 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 15.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara.
- Ankimues:** “Pastrime Silvio” ShPK
Rruga e “Fatmir Haxhiu”, Pallati 2, Shkalla 10, Apartamenti 76, Tiranë
- Autoriteti Kontraktor:** Agjencia e Blerjeve të Përqëndruara
Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë
- Baza Ligjore:** Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4 Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për

Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, i ndryshuar;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 23.03.2021, është publikuar nga autoriteti kontraktor, në faqen e internetit të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-90596-03-19-2021, me objekt: Loti I “Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues”, me fond limit 125,924,225.74 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 15.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 15.04.2021, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

II.3. Referuar informacionit të autoritetit kontraktor të dorëzuar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, autoriteti kontraktor në datë 18.05.2021 ka kryer vlerësimin e ofertave të operatorëve ekonomikë pjesëmarrës në këtë procedurë prokurimi. të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “Euro Mega 2010” ShPK.	65.700.000 lekë, kualifikuar
2. “AN&RA” ShPK.	69.672.023 lekë, Skualifikuar
3. “Murati D” ShPK.	78.441.388 lekë, Skualifikuar
4. “Get KLIN” ShPK.	82.656.110 lekë, Skualifikuar
5. “W. Ceneter” ShPK.	97.846.152 lekë, kualifikuar
6. “Atlantik 3” ShPK.	107.441.500 lekë, Skualifikuar
7. “Anbin” ShPK.	111.119.195 lekë, Skualifikuar
8. “Patsrime Silvio” ShPK.	118.728.361 lekë, kualifikuar

II.4. Në datën 21.05.2021 operatori ekonomik “Pastrime Silvio” ShPK ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor duke kundërshtuar kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 210” ShPK duke argumentuar si më poshtë vijon:

[...] Shoqëria “Pastrime Silvio” ShPK ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt Loti I “Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues”, të zhvilluar nga ABPmë datë 15.04.2021.

Më datë 18.05.2021 është publikuar klasifikimi dhe kualifikimi i ofertave si më poshtë:

1. “Euro Mega 2010” ShPK.	65.700.000 lekë, kualifikuar
2. “AN&RA” ShPK.	69.672.023 lekë, Skualifikuar
3. “Murati D” ShPK.	78.441.388 lekë, Skualifikuar
4. “Get KLIN” ShPK.	82.656.110 lekë, Skualifikuar
5. “E. Ceneter” ShPK.	97.846.152 lekë, kualifikuar
6. “Atlantik 3” ShPK.	107.441.500 lekë, Skualifikuar
7. “Anbin” ShPK.	111.119.195 lekë, Skualifikuar
8. “Patsrime Silvio” ShPK.	118.728.361 lekë, kualifikuar

Nga eksperiencia që kemi patur në tenderat e mëparshëm me të njëjtin oe mendojmë se ka këto mangësi në dokumentacion:

Së pari oe nuk ka fiskalizimin në kundërshtim me përcaktimin në DST.

Në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit”, i ndryshuar, operatorët ekonomikë të shpallur fitues për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

-Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave

OSE,

- Kopje të Certifikatës elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softëere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softëare-ike.

Së dyti oe është skualifikuar në Lotin II. Një nga kriteret e DST ishte: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk

plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Pra fakti që oe është skualifikuar në Lotin II rrjedhimisht ai nuk plotëson kriterin lidhur me xhiron apo shërbimet e ngjashme.

Nga llogaritja e ofertave të oe pjesmarrës në bazë të nenit 56 të LPP-së rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK është anomalisht e ulët. Në mënyrë që që një operator ekonomik me ofertë anomalisht të ulët të kualifikohet duhet të argumentojë ofertën e tij duke plotësuar në mënyrë kumulative këto 4 kushte:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;*
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;*
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;*
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.*

Operatori ekonomik Euro Mega 2010” ShPK nuk ka justifikuar ofertën e tij anomalisht të ulët, sa i takon të 4 komponentëve të nenit 56 të LPP-së si më sipër. Operatori ekonomik duhet të analizojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit/procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruar. Rrjedhimisht ai duhet të argumentojë të gjitha kostot e nevojshme duke përfshirë këtu fuqinë punëtore, të paraqesë fatura tatimore blerjeje/zhdoganimi, kosto administrative e operative, kosto e blerjes së produkteve apo e lëndës së parë ofertave që ka marrë nga subjekte/ente përkatëse. Pra i duhet një analizë e detajuar e ofertës së tij në mënyrë që të justifikojë çimin e ofertuar. OE nuk ka paraqitur një analizë të detajuar të ofertës së tij dhe nuk ka argumentuar apo provuar me anë të dokumentacionit plotësimin e këtij kriteri.

Operatori ekonomik duhet gjithashtu që të argumentojë zgjidhjet teknike të ofruara ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm. Ky oe nuk ka asnjë kusht të favorizues të jashtëzakonshëm. Cilësia prodhimit të detergjentëve është tejet e ulët jo e përshtatshme për institucionet të cilat duhet të furnizohen me materialet e kërkuara. Fakti që oe deklaroi që është prodhues nuk është kusht favorizues në drejtim të argumentimit të ofertës së tij pasi produktet e tij as nuk janë të çertifikuara as nuk janë të testuara nuk plotësojnë standartet minimale kombëtare e ndërkombëtare të prodhimit dhe tregtimit të detergjentëve. Lënda e parë nuk prodhohet nga ky oe dhe përse kohë që operatori nuk jep asnjë garanci për mallin që ofron si dhe cilësinë e lëndës së parë të përdorur nga ana e tij sigurisht që nuk mund të konsiderohet kusht favorizues.

Gjithashtu edhe origjinaliteti i mallit i lidhur me faktin që operatori është prodhues nuk vërtetohet nga ai vetë përse kohë që ligji kërkon plotësimin e disa kriterëve minimale për të qënë prodhues si psh lejet mjedisore të cilat ky oe nuk i ka për prodhimin e detergjentëve. Leja mjedisore që disponon ky operator është për prodhim kimikatesh dhe jo prodhim detergjentësh!!!

Përse kohë që operatori ekonomik nuk disponon lejene mjedisore të nevojshme për prodhimin e detergjentëve nuk arrin të provojë origjinalitetin e mallit të ofruar dhe as zgjedhjet teknike të ofruara apo kushtet favorizuese të jashtëzakonshme. Së fundmi operatori ekonomik duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Operatori ekonomik nuk ka një person të punësuar për zbatimin e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës . Ai nuk ka asnjë kompani të jashtme të kontaktuar për ofrimin e këtij shërbimi. Madje ky

operator ka qënë disa herë subjekt kontrolli i Inspektoriatit të Punës për kushte jo të favorshme të jashtëzakonshme. Përsa kohë që neni 56 i LPP-së kërkon përmbushjen në mënyrë kumulative të 4 kushteve të përcaktuara në të, vërtetohet lehtësisht që ai nuk i përmbush ato. Fakti i paraqitjes së një argumentimi narrativ ku ai bën një prezantim të subjektit të tij (në formë CV-je), dhe nuk ka paraqitur një analizë konkrete të detajuar të zërave të ofertës së tij, nuk ka paraqitur asnjë faturë tatimore shitjeje, nuk ka leje mjedisore për të qënë prodhues i detergjentëve (në kundëstimm me të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi) si dhe, fakti i mos provimit të zbatueshmërisë së detyrimeve në punë e bën këtë gjë të mjaftueshme për ta skualifikuar këtë operator. Përsa më sipër kërkojmë nga KSH-ja që të rivlerësojë ofertën e këtij operator dhe ta skualifikojë atë, si jo në përputhje me ligjin e prokurimeve publike dhe kërkesave të DST-së. [...].

II.6. Në datën 27.05.2021, me shkresën nr. 940/2 prot, operatori ekonomik “Patsrime Silvio” ShPK është vënë në dijeni në lidhje me refuzimin e ankesës së paraqitur prej tij.

II.7. Në datën 03.06.2021 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik me argumentat si më poshtë vijon:

[...] Shoqëria “Pastrime Silvio” ShPK ka marrë pjesë në procedurën e prokurimit me objekt Loti I “Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues”, të zhvilluar nga ABPmë datë 15.04.2021.

Më datë 18.05.2021 është publikuar klasifikimi dhe kualifikimi i ofertave si më poshtë:

9. “Euro Mega 2010” ShPK.	65.700.000 lekë, kualifikuar
10. “AN&RA” ShPK.	69.672.023 lekë, Skualifikuar
11. “Murati D” ShPK.	78.441.388 lekë, Skualifikuar
12. “Get KLIN” ShPK.	82.656.110 lekë, Skualifikuar
13. “Ë. Ceneter” ShPK.	97.846.152 lekë, kualifikuar
14. “Atlantik 3” ShPK.	107.441.500 lekë, Skualifikuar
15. “Anbin” ShPK.	111.119.195 lekë, Skualifikuar
16. “Patsrime Silvio” ShPK.	118.728.361 lekë, kualifikuar

Nga eksperiencia që kemi patur në tenderat e mëparshëm me të njëjtin oe mendojmë se ka këto mangësi në dokumentacion:

Së pari oe nuk ka fiskalizimin në kundëstimm me përcaktimin në DST.

Në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, operatorët ekonomikë të shpallur fitues për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

-Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave

OSE,

- Kopje të Certifikatës elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softëere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softëare-ike.

Së dyti oe është skualifikuar në Lotin II. Një nga kriteret e DST ishte: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë

ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar.

Pra fakti që oe është skualifikuar në Lotin II rrjedhimisht ai nuk plotëson kriterin lidhur me xhiron apo shërbimet e ngjashme.

Pra OE nuk ka përpiluar Deklaratën kumulative për Lotet pjesmarrëse në përputhje me kërkesën e DST.

Së treti Nga llogaritja e ofertave të oe pjesmarrës në bazë të nenit 56 të LPP-së rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK është anomalisht e ulët. Në mënyrë që një operator ekonomik me ofertë anomalisht të ulët të kualifikohet duhet të argumentojë ofertën e tij duke plotësuar në mënyrë kumulative këto 4 kushte:

- a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;
- b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;
- c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;
- ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Operatori ekonomik Euro Mega 2010” ShPK nuk ka justifikuar ofertën e tij anomalisht të ulët, sa i takon të 4 komponentëve të nenit 56 të LPP-së si më sipër. Operatori ekonomik duhet të analizojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit/procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruar. Rrjedhimisht ai duhet të argumentojë të gjitha kostot e nevojshme duke përfshirë këtu fuqinë punëtore, të paraqesë fatura tatimore blerjeje/zhdoganimi, kosto administrative e operative, kosto e blerjes së produkteve apo e lëndës së parë ofertave që ka marrë nga subjekte/ente përkatëse. Pra i duhet një analizë e detajuar e ofertës së tij në mënyrë që të justifikojë çimin e ofertuar. OE nuk ka paraqitur një analizë të detajuar të ofertës së tij dhe nuk ka argumentuar apo provuar me anë të dokumentacionit plotësimin e këtij kriteri.

Operatori ekonomik duhet gjithashtu që të argumentojë zgjidhjet teknike të ofruara ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm. Ky oe nuk ka asnjë kusht të favorizues të jashtëzakonshëm. Cilësia prodhimit të detergjentëve është tejet e ulët jo e përshtatshme për institucionet të cilat duhet të furnizohen me materialet e kërkuara. Fakti që oe deklaroi që është prodhues nuk është kusht favorizues në drejtim të argumentimit të ofertës së tij pasi produktet e tij as nuk janë të çertifikuara as nuk janë të testuara nuk plotësojnë standartet minimale kombëtare e ndërkombëtare të prodhimit dhe tregtimit të detergjentëve. Lënda e parë nuk prodhohet nga ky oe dhe përse kohë që operatori nuk jep asnjë garanci për mallin që ofron si dhe cilësinë e lëndës së parë të përdorur nga ana e tij sigurisht që nuk mund të konsiderohet kusht favorizues.

Gjithashtu edhe origjinaliteti i mallit i lidhur me faktin që operatori është prodhues nuk vërtetohet nga ai vetë përse kohë që ligji kërkon plotësimin e disa kriterëve minimale për të qënë prodhues si psh lejet mjedisore të cilat ky oe nuk i ka për prodhimin e detergjentëve. Leja mjedisore që disponon ky operator është për prodhim kimikatesh dhe jo prodhim detergjentësh!!!

Përse kohë që operatori ekonomik nuk disponon lejene mjedisore të nevojshme për prodhimin e detergjentëve nuk arrin të provojë origjinalitetin e mallit të ofruar dhe as zgjedhjet teknike të ofruara apo kushtet favorizuese të jashtëzakonshme. Së fundmi operatori ekonomik duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në

vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Operatori ekonomik nuk ka një person të punësuar për zbatimin e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës .Ai nuk ka asnjë kompani të jashtme të kontraktuar për ofrimin e këtij shërbimi. Madje ky operator ka qënë disa herë subjekt kontrolli i Inspektoriatit të Punës, për kushte jo të favorshme në punë.

Autoriteti kontraktor në kthimin e përgjigjes shprehet se “Konkretisht në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 e LPP-së i ndryshuar ofertuesi “Euro Mega 2010” ShPK krahas sqarimeve për ofertën anomalisht të ulët ka bashkëngjitur listën e çmimeve të produkteve që tregton të firmosurdhe vulosur nga ofertuesi tabela e kostove përkatësetë produkteve të cilat ai prodhon skeda teknike të sigurisë së materialeve etj.

Ky arsyetim i AK-së nuk është as bindës dhe as i bazuar në fakte e prova pasi oe duhet të justifikojë ofertën e tij për të gjithë artikujt sipas listës së çmimeve. Në mbështetje të argumentit tonë marrim si shembull artikujte mëposhtëm:

24	Insekticid për bletë/miza milingona	
24.1	Insekticid për bletë/miza milingona (ambalazh 500ml)	copë
24.2	Insekticid për bletë/miza milingona (ambalazh 1 litër)	copë
25	Malathion	kg
26	Rodenticide	kg
27	k-othrine (ose ekuivalent)	kg

Këto artikuj janë artikuj importi nuk prodhohen në Shqipëri (duke shtuar faktin që oe “Euro Mega 2010” ShPK nuk ka leje për prodhimin e insekticideve) dhe kërkohet Autorizim/Leje importi nga Ministria e Buqësisë/Shëndetësisë që të hyjnë të përdoren në territorin e RSH-së. Dyshojmë që në bazë të ofertës anomalisht të ulët të këtij oe për të gjithë artikujt e ofertës edhe çmimet për artikujt e lestuar më sipër janë mjaft të ulëta se sa çmimet e referencës të vendosura nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave, nën të cilat mund të tregtohen pasi duhet te shtohen ketu edhe kostot e tjera te nevojshme si: kosto transporti, kosto administrative, logjistike, operative, doganore etj. Pra, edhe nese çmimi i ofertuar eshte me i ulet se çmimi i references operatori duhet te argumentojte dhe justifikojte ate cmim te ulet. Shoqeria "Euro Mega 201 O" duhej te kishte paraqitur faturat doganore te blerjes se ketyre produkteve. Ashtu sic argumentuam me siper, keto jane produkte te cilat nuk mund te prodhohen ne Shqiperi (edhe ne rast se prodhohen ne Shqiperi, ky operator nuk ka leje per prodhimin e insekticideve) dhe per keto arsye, duhet te justifikohen nepermjet paraqitjes se faturave te blerjes/zhdoganimit dhe jo vetem me ane te (vete)deklaratave te ketij operatori.

Referuar çmimeve te references, te miratuar nga Drejtoria e Pergjithshme e Doganave, cmimi per artikullin 27 insekticidin Deltametrine (perberja e artikullit te kerkuar me emrin tregtar k-othrine) eshte 120,664- 120,665 USD/ton = 120 USD/kg = 12, 120)eke/kg, nderkohe qe ne dyshojme dhe mendojme qe oferta e ketij operatori eshte shume me e ulet se ky cmim. Keto

konstatime tonat, lidhen edhe me cmimet e tregut pasi, ne si operatore me experience ne kete fushe, kemi vazhdimisht kontakt me furnitore te ndryshem te produkteve te listuara me siper.

Pra, edhe argumentimi i kushtit te pare te pikes 1 te nenit 56 te LPP-se (anen ekonomike te metodet se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara) eshte konsideruar i rregullt nga ana e autoritetit kontraktor, arsyetimi dhe dokumentacioni i paraqitur nga ana e ketij operatori nuk eshte i plote, duke cuar ne kete menyre ne mangesi ne dokumentacion dhe argumentim jo te plote te ofertes se dorezuar nga ana e tij.

Edhe pse autoriteti kontraktor shprehet se operatori ekonomik ka dorezuar liste cmimesh dhe tabela kostosh, nuk ka dhene asnje argument apo arsyetim lidhur me 3 kriteret e tjera te kerkuara. Lista e cmimeve te dorezuar nga ana e shoqerise "Euro Mega 201 O" sh.p.k dhe skedat e sigurise se material eve jene te njeanshrne dhe te pabazuara, pasi jane te hartuara nga vete ky operator. Ky operator nuk ka justifikuar apo provuar se kjo liste ccmimesh eshte reale, nuk ka vertetuar qe faturat e dorezuara nga ana e tij jane te deklaruar prane organeve tatimore, por jane vetem vetedeklarata te tij.

Edhe vete autoriteti kontraktor ne argurnentimet e tij, shprehet vetern per njeren prej kushteve te nenit 56 te LPP-se, germes "a" lidhur me "anen ekonomike te metodet se ndertimit, procesit te prodhimit ose te sherbimeve te ofruara", dhe jo me plotesimin e 3 kushteve te tjera te kerkuara. Ne rastin kur oferta eshte anomalisht e ulet, barra e proves per justifikimin e ofertes anomalisht te ulet, i takon operatorit oferta e te cilit eshte konstatuar anomalisht e ulet dhe me tej, eshte autoriteti kontraktor qe vlereson ne baze te provave dhe argurnenteve te operatorit, nese ato qendrojne apo jo.

Argumentimi vetem i 1 kushti te ketij neni, nuk e ben argumentimin e ofertes anormalisht te ulet te vlefshme pasi, operatoret ekonomike oferta e te cileve konstatohet anormalisht e ulet duhet te justifikojne oferten e tyre ne baze te nenit 56 te LPP-se, duke argumentuar dhe justifikuar ne rrenyre kumulative te 4 kushtet e percaktuara nga ky nen.

Per sa kohe qe neni 56 i LPP-se kerkon permbushjen ne menyre kumulative te 4 kushteve te percaktuara ne te, vertetohet lehtesisht qe ai nuk i perrnbush ato. Fakti i paraqitjes se nje argumentimi narrativ, ku ai ben nje prezantim te subjektit te tij (ne forme CV-je), dhe nuk ka paraqitur nje analize konkrete, te detajuar, te zerave te ofertes se tij, nuk ka paraqitur asnje fature tatimore shitjeje, nuk ka leje rnjedisore per te gene prodhues i detergjenteve (ne kundershirtin mete gjitha ligjet dhe rregullat ne fuqi) si dhe, fakti i mos-provirnit te zbatueshmerise se detyrimeve ne pune, e ben kete gje temjaftueshme për ta skuafikuar këtë operator. [...]

II.5. Me shkresën me nr. 1033/1 prot, datë 11.06.2021, protokolluar me tonën me nr. 978/2 prot, datë 15.06.2021, me objekt “Dërgim informacioni dhe dokumentacioni për Lotin 1 “Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues” me REF-90596-03-19-2021,” është depozituar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit për trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, si edhe informacionit dhe dokumentacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” ShPK mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se: *“Së dyti oe është skualifikuar në Lotin II. Një nga kriteret e DST ishte: Operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të ketë kapacitetet ekonomike – financiare (nënpika 1 e seksionit 2.2, të kriterëve të veçanta për kualifikim) si dhe kapacitetet teknike (nënpika 1 seksionit 2.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim), sa shuma e loteve për të cilat ka ofertuar, të marra së bashku. Në këtë rast, operatori ekonomik ofertues në më shumë se një Lot, duhet të paraqesë një deklaratë ku të listohen dokumentet e paraqitura në përmbushje të kriterëve kumulative për Lotin konkret. Në rast se dokumentacioni i deklaruar dhe i dorëzuar në përmbushje të kriterëve kumulative nuk plotëson kapacitetet ekonomike - financiare dhe kapacitetet teknike për të gjitha Lotet ku operatori ekonomik ka ofertuar, do të skualifikohet nga të gjitha Lotet ku ka ofertuar. Pra fakti që oe është skualifikuar në Lotin II rrjedhimisht ai nuk plotëson kriterin lidhur me xhiron apo shërbimet e ngjashme.[...]., Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.1.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues, (thema decidendum) në zbatim të nenit 64 pika 3 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 *“Për prokurimin publik”* të ndryshuar, parashikohet se: *“3. Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik, kur gjykon se një vendim apo veprim i autoritetit kontraktor ka shkelur ndonjë nga dispozitat e këtij ligji,ka të drejtë:*

a) të nxjerrë një interpretim për rregullat ose parimet ligjore, që duhet të zbatohen për objektin e ankesës;

b) të anulojë, plotësisht ose pjesërisht, një veprim ose vendim të autoritetit kontraktor, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin. Kjo përfshin edhe të drejtën për të hequr të gjitha ato specifikime teknike ose llojet e tjera të specifikimeve që bien ndesh me këtë ligj;

c) të udhëzojë autoritetin kontraktor të korrigjojë shkeljet dhe më pas të vazhdojë me procedurën e prokurimit të kontratës;

ç) të urdhërojë anulimin e procedurave për shpalljen e kontratës fituese”.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se, referuar parashtrimeve me shkrim të operatorit ekonomik ankimues, ky i fundit, referuar ankesës së dorëzuar pranë autoritetit kontraktor dhe më pas pranë Komisionit të Prokurimit Publik ka parashtruar pretendime në lidhje me mospërmbushjen e kriterëve të vecanta të kualifikimit në lotin e procedurës së prokurimit të ankimuar duke e lidhur këtë të fundin me kualifikimin e po të njëjtit operator ekonomik edhe në lotet e tjera të procedurës së prokurimit duke ngritur pretendime se *ipso facto*- fakti që operatori ekonomik është kualifikuar në lotet e tjera të procedurës së prokurimit nuk përmbush kriterin/et e vecanta të kualifikimit si vlerësim kumulativ i tyre në procedurën konkrete të prokurimit (ipso legge). Në rastin konkret, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se para shqyrtimit në themel të

pretendimeve të operatorit ekonomik ankimues në lidhje me pretendimet e mësipërme të ndalet fillimisht në legjitimitimin e palës për kërkimin e mësipërm. Në nenin 63 pika 1.1 dhe 2 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, parashikohet se: “ 1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin. 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.” Gjithashtu, ligjvënësi ka parashikuar edhe rregulla strikt mbi procedurën e shqyrtimit të ankesave si nga autoriteti kontraktor ashtu edhe nga Komisioni i Prokurimit Publik, në cilësinë e organit më të lartë të shqyrtimit të ankesave në fushën e prokurimeve publike, në zbatim edhe të nenit 19/1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, ligjvënësi ka paraparë, se ankesa pranë Komisionit të Prokurimit Publik bëhet kundrejt pagesës. Rregullat dhe tarifat e pagesës përcaktohen me vendim të Këshillit të Ministrave (neni 63 pika 10). Ndërkohë, në nenin 1,2,3 dhe 4 të Vendimit nr.216 datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “ Për Përcaktimin e Tarifës dhe të Rregullave për Pagimin e saj, në një Procedurë Ankimimi, pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, parashikohet se: “1.Ankesa e paraqitur në rrugë elektronike, pranë Komisionit të Prokurimit Publik (KPP), nga çdo person që ka ose ka pasur një interes të ligjshëm në një procedurë prokurimi, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, të ndryshuar, duhet të përmbajë dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse. 2.Përjashtimisht, kur legjislacioni në fuqi parashikon një mjet tjetër komunikimi, ankesa e paraqitur pranë KKP-së shoqërohet me dokumentin bankar, që vërteton pagesën paraprake të tarifës përkatëse në numër të llogarisë të KPP-së. 3.Për shqyrtimin e ankesës nga KPP-ja, përcaktohet kjo tarifë pagese, e cila është 0,5% e vlerës së fondit limit në procedurën e prokurimit, që ankimohet. 4.Parapagimi i tarifës nga ankuesi përbën element të domosdoshëm për paraqitjen e ankesës, ndërsa moskryerja e tij përbën shkak për mospranimin e ankesës nga KPP-ja” . Në Vendimin nr. 596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik” parashikohet shprehimisht se: *Ankesa drejtuar Komisionit paraqitet në gjuhën shqipe në përputhje me formularin standard të ankesës sipas modelit të aneksit nr. 2, që i bashkëlidhet kësaj rregulloreje. Komisioni publikon në faqen zyrtare formularin standard të ankesës.*

2. Ankesa duhet të përmbajë domosdoshmërisht elementet e mëposhtme:

a) Të dhënat identifikuese të ankimesit;

b) Referimin për procedurën konkrete mbi të cilën paraqitet ankimi

c) Bazën ligjore;

d) Një përshkrim të shkurtër të shkeljes së pretenduar;

e) Shkallët e ankimit shoqëruar me dokumentacionin përkatës dhe vendimin e autoritetit kontraktor, nëse ka;

f) Dokumentin bankar që vërteton pagesën e tarifës përkatëse për ankesën;

g) Pretendimin e ankuesit për vendimin përfundimtar.

3. Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me:

a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni;

b) kërkesën për përjashtimin e ndonjë anëtari të Komisionit për shkak të konfliktit të interesit, nëse ankimuesi ka dijeni paraprakisht për shkakun;

c) kërkesën për ekspertizë të posaçme, kur kjo çmohet e nevojshme për zgjidhjen e çështjes

III.1.2. Referuar procedurës së prokurimit objekt ankimi, KPP konstaton se kjo procedurë prokurimi është e ndarë në lotë dhe vetë operatori ekonomik ankimues parashtrohet pretendime në lidhje me përmbushjen e kriterëve të kualifikimit nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK referuar loteve ku ky i fundit ka marrë pjesë.

III.1.3. Neni 29 i Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht:

Kur kontratat për punë/mall/shërbim ndahet në lote, autoriteti kontraktor duhet të hartojë kërkesat e veçanta të kualifikimit për secilin lot. Kërkesat duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me objektin, natyrën dhe vlerën e lotit.

“Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedurës

III.1.4. KPP vëren se ankimuesi në parashtrimet në ankesë kundërshton kualifikimin e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK me argumentat se nuk plotëson kushtet kumulative për të gjitha lotet. Ndërkohë KPP vëren se ankesa e operatorit ekonomik ankimues i referohet vetëm lotit 1 me objekt “*Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues*”, dhe rrethimisht ankimuesi ka paguar tarifën e ankesës vetëm për lotin 1. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se neni 63 pika 1.1. e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “*Për prokurimin publik*” të ndryshuar rregullon të drejtën e personave të interesuar në një procedurë prokurimi për të paraqitur ankesë në KPP, në kuadrin e rishikimit administrativ të kësaj procedure, e thënë ndryshe, legjitimitimin për të vënë në lëvizje KPP.

Procedura përpara KPP ka natyrën e procedurave të nxitura (*lat.-jurisdicion voluntari*) pasi KPP nuk mund të bëhet vetiniciatore e fillimit të procedurave (ex officio). Si rregull, investimi i KPP është i bazuar (faktikisht i kufizuar) nga ankimet e sjella pranë saj vetëm nga subjekte të legjitimuar. KPP sqaron Interesi në gjykim përcakton edhe pozitën procedurale të palëve në proces. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson se e drejta ligjore e subjektit për parashtrimin e një pretendimi para Komisionit të Prokurimit Publik për mborjtjen e një interesi të caktuar që njihet si legjitimimi, së bashku me çështjen e kompetencës lëndore të organit administrativ njihet që specifikohen ndryshe edhe si “objekti i ankesës” (*pika 2 gërma “g” e Vendimit nr.596/2018, datë 12.09.2018 të Komisionit të Prokurimit Publik “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*) si edhe kushti i shterimit të ankimit administrativ

pranë autoritetit kontraktor (neni 63 pika 2 e ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar) janë kriteret përcaktuese për të filluar edhe një shqyrtim administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik. KPP konstaton se operatori ekonomik ankimues ka parashtruar pretendime në lidhje me ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor për kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK duke e lidhur këtë të fundit me ligjshmërinë e veprimeve (kualifikimin/skualifikimin) nga lote të tjera të procedurës së prokurimit, për të cilat, operatori ekonomik ankimues nuk ka shteruar rrugën e ankimit administrativ pranë autoritetit kontraktor si edhe Komisionit të Prokurimit Publik në respekt të nenit 63 pika 2,3,5,6,10 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar. Kështu, KPP konstaton se operatori ekonomik me anë të ankesë së tij për lotin e procedurës së prokurimit objekt ankimi ka kërkuar kryerjen e rishikimit administrativ referuar loteve të tjera të procedurës së prokurimit për të cilat nuk janë përmbushur asnjë nga kushtet formale të paraqitjes së ankesës. Në nenin 29 të Vendimit nr.914 datë 29.12.2014 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” të ndryshuar parashikohet shprehimisht se: “ “Në çdo rast, lotet janë të organizuara si procedura të veçanta brenda një procedure. Fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër të procedure” . Në rregullat e prokurimit publik është përcaktuar qartësisht se fillimi dhe përfundimi i njërit lot nuk ndikon në lotin tjetër duke e paraparë si procedurë të veçantë brenda një procedure. Në rastin konkret, që ankimuesi të gëzoj lëgjitimet aktiv si edhe legjitimitet të vërë në lëvizje Komisionin e Prokurimit Publik (*lat- locus standi*) të shqyrtojë dhe vlerësojë dokumentacionin e paraqitur nga operatorë të tjerë ekonomikë në lote të tjera të procedurës së prokurimit do të duhej që ankimuesi të kishte ezauruar ankim administrativ edhe për lotet në të cilat ngre pretendime. Në të kundërt, Komisioni i Prokurimit Publik nuk gëzon kompetenca lëndore të shqyrtimit të ligjshmërisë së veprimeve (kualifikimit/skualifikimit) të operatorëve të tjerë ekonomikë, megjithëse ankesa është e lidhur me lotin konkret, në lote për të cilat nuk është ushtruar e drejta e ankimit e për rrjedhojë KPP nuk ka ushtruar të drejtën e tij ligjore të shprehet si me vendime të ndërmjetme për pezullimin e procedurës dhe /ose kërkimin e informacionit si edhe me vendim përfundimtar mbi themelin e çështjes. Komisioni i Prokurimit Publik vlerëson të sqarojë se ky i fundit është paraparë nga ligjvënësi si një organ “sui generis”, për të cilin Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut ka përdorur termin e ri leksikor, quasi gjykatë, e pranuar edhe nga Gjykata Kushtetuese. Në rastin konkret, ankesa në KPP dhe rishikimi administrativ i procedurës së prokurimit kushtëzohet nga dy komponentë bazë, ai i ndjekjes së rrugës së ankimit administrativ pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe i kryerjes së veprimeve procedurale (pagimit të tarifës) si shkak për nisjen e shqyrtimit administrativ. Sa më sipër, KPP gjykon se kjo e fundit nuk mund të shqyrtojë dhe vlerësojë mbi dokumentacione të dorëzuara në lote të tjera të procedurës së prokurimit në kushtet për faj të ankimuesit ky i fundit nuk ka ezauruar ankimin administrativ në përputhje me kuadrin ligjor në fuqi për lotet e mësipërme.

Sa më sipër KPP gjykon se nuk mund të marrë në shqyrtim pretendimet e sipërcituara të ankimuesit për pretendime që lidhen me përmbushjen e kushteve kumulative për të gjitha lotet por do të gjykojë të gjitha pretendimet e ngitura nga ankimuesi që kanë lidhje me lotin objekt ankimi si më poshtë vijon:

III.1.4.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” ShPK mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se: *“Pra OE nuk ka përpiluar Deklaratën kumulative për Lotet pjesmarrëse në përputhje me kërkesën e DST. [...]”*,

III.1.4.2. Komisioni i Prokurimit Publik sjell në vëmendje nenin 63, pika 1, 2, 5 dhe 6, të ligjit nr. 9643, dt.20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, në të cilin është parashikuar:

1. Çdo person, që ka ose ka pasur interes në një procedurë prokurimi dhe kur është dëmtuar ose rrezikohet të dëmtohet nga një vendim i autoritetit kontraktor, i marrë në kundërshtim me këtë ligj, mund ta kundërshtojë vendimin.

1.1 Në rastin e ankesave për dokumentet e tenderit, operatorët ekonomikë mund të ankohen pranë autoritetit kontraktor brenda 7 ditëve nga data e publikimit të njoftimit të kontratës në faqen në internet të Agjencisë së Prokurimit Publik. Me marrjen e ankesës me shkrim, autoriteti kontraktor pezullon vazhdimin e procedurës së prokurimit, derisa ankesa të jetë shqyrtuar plotësisht, përfshirë dhe nxjerrjen e një vendimi brenda 3 ditëve nga data e depozitimit të ankesës. Ndaj vendimit përfundimtar të autoritetit kontraktor mund të bëhet ankim në Komisionin e Prokurimit Publik, në përputhje me pikën 6 e në vijim të këtij neni.

1.2 2. Ankesa kundër vendimeve të autoritetit kontraktor i paraqitet, së pari, me shkrim, autoritetit kontraktor në fjalë brenda 7 ditëve nga dita e nesërme e punës kur ankimuesi është vënë në dijeni ose duhet të ishte vënë në dijeni për shkeljen e pretenduar, sipas këtij ligji.

1.3 5. Autoriteti kontraktor shqyrton ankesën dhe merr një vendim të arsyetuar brenda 7 ditëve pas marrjes së ankesës, të cilin duhet t’ia njoftojë ankuesit jo më vonë se në ditën vijuese të punës.

1.4 6. Nëse autoriteti kontraktor nuk shqyrton ankesën brenda afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose e refuzon atë, ankimuesi mund të paraqesë një ankesë me shkrim në Komisionin e Prokurimit Publik brenda 10 ditëve nga dita e nesërme e punës, pas përfundimit të afatit kohor, të përcaktuar në pikën 5 të këtij neni, ose, në rast se ankesa nuk pranohet nga autoriteti kontraktor, që nga dita kur ankuesi është njoftuar nga autoriteti kontraktor. Një kopje me shkrim e ankesës i dërgohet detyrimisht edhe autoritetit kontraktor”.

III.14.1.3. Sa më sipër, KPP gjykon se pretendimi i operatorit ekonomik ankimues i ngritur pranë KPP-së lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK nuk ka respektuar shkallët e ankimit të parashikuar nga neni 63 i LPP si më sipërcituar. KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues në momentin e ngritjes së pretendimit mbi kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega2010” ShPK duhet të kishte paraqitur ankesë së pari pranë autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimit. Ankimi i paraqitur nga operatori ekonomik ankimues pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke mos respektuar shkallët e ankimit sikurse përcaktohet në ligjin e sipërcituar, sjell si pasojë që ai të mos ketë përmbushur detyrimin për ndjekjen e afateve ligjore të ankimit në autoritetin kontraktor, duke mos plotësuar në këtë mënyrë njërin nga “elementet e domosdoshëm të ankesës” dhe përbën shkak për mospranimin e ankesës nga ana e Komisionit të Prokurimit Publik.

KPP gjykon se operatori ekonomik ankimues, në respektim të shkallëve të ankimimit, duhet të kishte ngritur këto pretendime pranë autoritetit kontraktor, ashtu sikurse është përcaktuar specifikisht në ligjin e prokurimit publik. Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se nuk mund të shprehet mbi pretendime të cilat nuk janë bërë paraprakisht objekt ankese pranë autoritetit kontraktor. Objekti i ankesës së paraqitur pranë autoritetit kontraktor në respekt të shkallëve të ankimimit nuk mund të shtohet në momentin e paraqitjes në KPP.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, për shkak të ligjit (ipso lege), pretendimet e operatorit ekonomik ankimues lidhur me kualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK në lidhje me këtë pikë e cila nuk është ngritur fillimisht pranë autoritetit kontraktor, nuk mund të merret në shqyrtim nga KPP.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” ShPK mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se: *“Së pari oe nuk ka fiskalizimin në kundërshtim me përcaktimin në DST. Në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, operatorët ekonomikë të shpallur fitues për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të procedurës, duhet të kenë: -Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave OSE, Kopje të Certifikatës elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softëere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softëare-ike.. [...]., Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:*

III.2.1. Në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt ankimi, nga ana e autoritetit kontraktor, në “Njoftimin e kontratës”, është kërkuar:

Shenime te tjera

Në zbatim të ligjit Nr. 87/2019 "Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit", i ndryshuar, operatorët ekonomikë të shpallur fitues për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të procedurës, duhet të kenë:

- *Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin, për tatimpaguesit që përdorin Platformen Qendrore të Faturave*

OSE,

- *Kopje të Certifikatës elektronike per Fiskalizimin dhe Kopje të vlefshme të Kontratës së lidhur me Shoqërinë e Certifikuar për zgjidhjen softëere-ike në përdorim, për tatimpaguesit që lëshojnë faturat nëpërmjet zgjidhjes softëare-ike.*

III.2.2. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK në sistemin e prokurimeve elektronike rezulton se, ky i fundit ka dorëzuar kontratë shërbimi lidhur nëpërmjet shoqërisë “EuroMega 2010” ShPK në cilësinë e blerësit dhe “Image & Communications Development” ShPK në cilësinë e shitësit, në të cilin parashikohet se shitësi i shtet blerësit abonim në sistemin devPOS (për kryerjen e proceseve të fiskalizimit sipas ligjit nr. 87/2019 “Për faturën dhe sistemin e monitorimit të qarkullimit” i ndryshuar[...]). Akoma më tej,

nga interpretimi literal i kërkesës së autoritetit kontraktor mbi dorëzimin e certifikatës elektronike për fiskalizimin, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se ky i fundit ka përjashtuar rastin e dorëzimit të kopjes të certifikatës elektronike për fiskalizimin, dhe ka parashikuar si moment të dorëzimit të këtij dokumenti konkretisht (citojmë): “[...] operatorët ekonomikë të shpallur fitues për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të procedurës, duhet të kenë: Kopje të Certifikatës elektronike për Fiskalizimin[...].”

Pretendimi i operatorit ekonomik ankimues se “[...]Së pari oe nuk ka fiskalizimin në kundërshtim me përcaktimin në DST.[...]” është i lidhur me një interpretim *ex post* pas vlerësimit të ofertave të kërkesës së autoritetit kontraktor. Autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë të shpallur fitues për nënshkrimin e një kontrate publike në përfundim të procedurës, duhet të kenë kopje të certifikatës elektronike për fiskalizim. Në këtë kuptim autoriteti kontraktor ka qënë i qartë në kërkesën e mësipërme e më tej në vlerësimin e operatorëve ekonomikë pjesmarrës, në respekt të parimit të barazisë në trajtimin e kërkesave dhe detyrimeve që u ngarkohen ofertuesve.

III.2.3. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se në zbatim të nenit 46 pika 1, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese” dhe të nenit 53/3 të LPP-së përcakohet se: “Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit...”. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK ka përmbushur kriterin e mësipërm të vendosur nga autoriteti kontraktor.

Sa më sipër pretendimi i operatorit ekonomik ankimues nuk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” ShPK mbi kualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK në procedurën e prokurimit objekt shqyrtimi me arsyetimin se: “Nga llogaritja e ofertave të oe pjesmarrës në bazë të nenit 56 të LPP-së rezulton se oferta e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK është anomalisht e ulët. Në mënyrë që që një operator ekonomik me ofertë anomalisht të ulët të kualifikohet duhet të argumentojë ofertën e tij duke plotësuar në mënyrë kumulative këto 4 kushte:

anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

Operatori ekonomik Euro Mega 2010” ShPK nuk ka justifikuar ofertën e tij anomalisht të ulët, sa i takon të 4 komponentëve të nenit 56 të LPP-së si më sipër. Operatori ekonomik duhet të analizojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit/procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruar. Rrjedhimisht ai duhet të rgumentojë të gjitha kostot e nevojshme duke përfshirë këtu fuqinë punëtore, të paraqesë fatura tatimore blerjeje/zhdoganimi, kosto administrative e operative, kosto e blerjes së produkteve apo e lëndës së parë ofertave që ka marrë nga subjekte/ente përkatëse. Pra i duhet një analizë e detajuar e ofertës së tij në mënyrë që të justifikojë çimin e ofertuar. OE nuk ka paraqitur një analizë të detajuar të ofertës së tij dhe nuk ka argumentuar apo provuar me anë të dokumentacionit plotësimin e këtij kriteri.

Operatori ekonomik duhet gjithashtu që të argumentojë zgjidhjet teknike të ofruara ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm. Ky oe nuk ka asnjë kusht të favorizues të jashtëzakonshëm. Cilësia prodhimit të detergjentëve është tejet e ulët jo e përshtatshme për institucionet të cilat duhet të furnizohen me materialet e kërkuara. Fakti që oe deklaroi që është prodhues nuk është kusht favorizues në drejtim të argumentimit të ofertës së tij pasi produktet e tij as nuk janë të çertifikuara as nuk janë të testuara nuk plotësojnë standartet minimale kombëtare e ndërkombëtare të prodhimit dhe tregtimit të detergjentëve. Lënda e parë nuk prodhohet nga ky oe dhe përse kohë që operatori nuk jep asnjë garanci për mallin që ofron si dhe cilësinë e lëndës së parë të përdorur nga ana e tij sigurisht që nuk mund të konsiderohet kusht favorizues. Gjithashtu edhe orgjinaliteti i mallit i lidhur me faktin që operatori është prodhues nuk vërtetohet nga ai vetë përse kohë që ligji kërkon plotësimin e disa kriterëve minimale për të qënë prodhues si psh lejet mjedisore të cilat ky oe nuk i ka për prodhimin e detergjentëve. Leja mjedisore që disponon ky operator është për prodhim kimikatesh dhe jo prodhim detergjentësh!!! Përse kohë që operatori ekonomik nuk disponon lejene mjedisore të nevojshme për prodhimin e detergjentëve nuk arrin të provojë orgjinalitetin e mallit të ofruar dhe as zgjedhjet teknike të ofruara apo kushtet favorizuese të jashtëzakonshme. Së fundmi operatori ekonomik duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. Operatori ekonomik nuk ka një person të punësuar për zbatimin e detyrimeve që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës . Ai nuk ka asnjë kompani të jashtme të kontaktuar për ofrimin e këtij shërbimi. Madje ky operator ka qënë disa herë subjekt kontrolli i Inspektoriatit të Punës për kushte jo të favorshme të jashtëzakonshme. Përse kohë që neni 56 i LPP-së kërkon përmbushjen në mënyrë kumulative të 4 kushteve të përcaktuara në të, vërtetohet lehtësisht që ai nuk i përmbush ato. Fakti i paraqitjes së një argumentimi narrativ ku ai bën një prezantim të subjektit të tij (në formë CV-je), dhe nuk ka paraqitur një analizë konkrete të detajuar të zërave të ofertës së tij, nuk ka paraqitur asnjë faturë tatimore shitjeje, nuk ka leje mjedisore për të qënë prodhues i detergjentëve (në kundërshtim me të gjitha ligjet dhe rregullat në fuqi) si dhe, fakti i mos provimit të zbatueshmërisë së detyrimeve në punë e bën këtë gjë të mjaftueshme për ta skualifikuar këtë operator. Përse më sipër kërkojmë nga KSH-ja që të rivlerësojë ofertën e këtij opeartori dhe ta skualifikojë atë, si jo në përputhje me ligjin e prokurimeve publike dhe kërkesave të DST-së. [...]., Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.3.1. Në nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikon se “[...] 1. Kur autoriteti kontraktor vëren se një ose më shumë oferta për kontratat e mallrave, punëve apo shërbimeve janë anomalisht të ulëta, ai, përpara se të vazhdojë me procesin e vlerësimit të ofertave, i kërkon operatorit ekonomik përkatës të paraqesë me shkrim dhe brenda 3 ditëve pune shpjegime për elemente të veçanta të ofertës, për: a) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara; b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve; c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi; ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. 2. Autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj[...].”

III.3.2. Në nenin 66 pika 5 të VKM nr.914 datë 29.12.2014 për “Miratimin e rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikon se “Pas korrigjimit të gabimeve aritmetike, komisioni i vlerësimit të ofertave verifikon nëse ofertat e vlefshme janë ose jo me çmim anomalisht të ulët sipas formulës së përcaktuar në dokumentet standarde të tenderit. Përlllogaritja e ofertës anomalisht të ulët bëhet në mënyrat e mëposhtme: Në rastin kur janë të vlefshme dy ose më pak oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët kur ajo është ulur më shumë se 25% e fondit limit të përlllogaritur. Në rastin kur janë të vlefshme tre ose më shumë oferta, në përputhje me nenin 56 të LPP, oferta vlerësohet anomalisht e ulët nëse vlera e saj do të jetë më e vogël se 85% e mesatares së ofertave të vlefshme. Nëse një apo disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, komisioni i vlerësimit të ofertave duhet të kërkojë sqarime nga ofertuesit, përpara se të marrë vendim për kualifikimin ose jo të tyre, në përputhje me nenin 56 të LPP. Në çdo rast ofertuesi ka detyrimin të argumentojë dhe të dokumentojë me prova shkresore sqarimet për elementin/elementet e veçanta të ofertës, në përputhje me kërkesat e nenit 56 të LPP. [...]”

III.3.3. Referuar informacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor rezulton se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK është njoftuar me anë të shkresës nr. 883prot datë 12.05.2021 lidhur me ofertën anomalisht të ulët ku autoriteti kontraktor i ka kërkuar sqarime mbi të në përputhje me nenin 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar.

III.3.4. Nga shqyrtimi i informacionit dhe dokumentacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor rezulton se nga ana e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK me synim justifikimin/argumentimin e ofertës anomalisht të ulët është paraqitur dokumentacioni si më poshtë:

Shkresë nr. 883/1prot., datë 17.05.2021 me lëndë: “Argumentim i cmimit të ofruar” me përmbajtje si vijon:[...] Ne pergjigje te kerkeses tuaj per shpjegime per elementet e vecante te ofertes sone si dhe mbi oferten anomalisht te ulet "Argumentim dhe dokumentim me prova shkresore ne lidhje me analizen e koston dhe elementet e vecante te ofertes sone" ne zbatim nenin 56 te Ligjit nr. 9643

date 20.11.2006 "Per prokurimin publik", i ndryshuar dhe nenit 66 pika 5 te V.K.M. nr. 914 date 29.12.2014 "Per rregullat e prokurimit publik" dhe DT pika 3.3

b) anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara;

b) zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve;

c) origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi;

ç) zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi.

per oferte anomalisht te ulet po ju parashtrojme arsyetimet tona :

1. Shoqeria "Euro Mega 2010" shpk ka objektin kryesor te veprimtarise se saj, midis te tjerave, prodhimin e detergjenteve, solucioneve higjenizuese dhe dezinfektuese . Kjo eshte e verifikueshme edhe ne ekstraktin e QKB te dorezuar ne sistemin elektronik SPE. Duke qene se jemi prodhues per mallrat objekt prokurimi detergjent dhe solucione pastrimi atehere nuk kemi perfshire ne oferte kostot qe kane shoqerite qe i tregetojne keto materiale te tilla si shpenzime transporti, shpenzime doganore si dhe akciza e plastikes ne dogane etj pasi ne jemi "dora e pare " duke prodhuar vet direkt nga lenda e pare qe na vjen.
2. Shoqeria "Euro Mega 2010" shpk eshte nje shoqeri lider ne Shqiperi per prodhimin e detergjenteve ,materialeve te pastrimit dhe solucioneve dezifektuese (alkool, xhel duarsh, dhe dezifektant siperfaqe) dhe ka kontrata furnizimi te shumta si me subjekte shteterore ashtu edhe ato private ne te gjithë vend.in, duke qene se kosto e prodhimit te tyre eshte e ulet ne konkurrojme me cmimet me te mira ne treg.
3. Shoqeria "Euro Mega 2010" shpk se fundmi po perfundon me sukses Marreveshjen kuader te shpallur nga Agjencia e Blerjeve te Pergendruara Loti I me objekt "Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues" Sipas Marreveshjes Kuader me Nr. 13/13 Prot., date 05.06.2019, me afat 2 vjecar (24 muaj)": loti 1: REF -12834--03-07-2019. Si dhe Loti II me objekt "Blerje materiale pastrimi" Sipas Marreveshjes Kuader me Nr. 13/14 Prot., date 05.06.2019, "Marreveshje Kuader (ku jo te gjithakushtet iane te percaktuara)" per lotin 2 - "Blerje materiale te ndryshme per pastrim",gjitha kushtet jane te percaktuara)" Objekti i Prokurimit: Blerje materiale te ndryshme per pastrim -Marreveshie Kuader me disa operator ekonomik-ku jo te gjitha kushtet iane te percaktuara- me afat 2yiecar (24 muaj)": loti 2: REF -12834--03-07-2019. Ky eshte nje garaci per ju se ne jemi kompani serioze ne treg dhe operojme me cmime konkurruese. Edhe ne Marreveshjen kuader te meparshme kemi hyr me oferte anomalisht te urnt. dhe po e perfundojme me sukses me te gjithë Autoritetet Kontraktuese te Marreveshjes kuader.
4. Ashtu sikurse kemi provuar edhe ne oferte, shoqeria "Euro Mega 2010" shpk eshte e pajisur me certifikata cilesie ISO 9001:2015 "Certifikim I sistemit per menaxhimin e cilesise "ISO 14001:2015 "Certifikim i sistemit per menaxhimin mjedisor" ISO

45001:2018 "Cetifikimi i sistemit per menaxhimin e sigurise dhe shendetit ne pune" certifikime keto te cilat garantojne zbatueshmerine e detyrimeve te legjislacionit te punes, shendetit dhe sigurise ne pune , sigurise se menaxhimit te mjedisit sipas legjislacionit mjedisor ne fuqi dhe cilesise se produkteve tona konfom direktivave CE dhe standarteve europiane.

5. Produktet nen marken "EURO MEGA 2010" sh.p.k jane te pajisura me SKEDAT E SIGURISE SE MATERIALEVE (Material Safety Datasheet, . MSDS) , te cilat jane sipas Rregulloreve Europiane ku percaktohet qe produktet qe tregtohen duhet te jene te pajisura me keto Skeda , ne te cilat tregohet perdorimi dhe garancia e tyre ne treg. (Ndodhen bashkëlidhur).
6. Shoqeria jone eshte e pajisur me leje mjedisore te Grupit A e cila eshte shume e rendesishme per kompanite prodhuese, si dhe monitorimin e vazhdueshem nga institucioni perkates Qendra Kombetare te Monitorimit te Mjedisit(QMM) me raportet e monitorimit periodike, e cila verteton përmes raporteve periodike shprehet se Kompania jonë është Brenda të gjitha parametrave të lejuara . Garanton Sigurine e produkteve tona dhe gjithashtu teknologjia e prodhimit e perdorur eshte ne mbrojtje te mjedisit. (Raportet e monitorimit 6 mujor i kemi bashkangjitur).
7. Produktet EURO MEGA jane te pajisura me marken e regjistrimit (Bashkelidhur me më poshtë).
8. Produktet EURO MEGA jane te pajisura me analizat vjetore , te cilat i kryejme cdo vit, nga Inspektorati Shteteror Teknik dhe Industrial (ISHTI), i cili eshte organi pergjegjes i cili pergjigjet per inspektimin, zbatimin dhe permbushjen e kerkesave ligjore dhe nenligjore ne fushen sigurise se punës, sigurise se produkteve te cilat permbajne kimikate. Shoqeria jone i ka kaluar te gjitha kerkesat dhe i permbush kushtet duke garantuar produkte te sigurta ne treg. (Bashkëlidhur më poshtë).
9. Cilesia e mallrave objekt prokurimi, ku ne jemi vet prodhues te tyre, eshte me nje cilesi maksimale dhe standart lider ne tregun shqiptar dhe ne mbajrne pergjegjesi per cilesi maksimale dhe eftkasitet 100% te produkteve tona. Shoqeria jone operon ne treg prej mee shume se 10 vitesh dhe I kemi permbushur kontratat. Mbajme pergjegjesi dhe pergjigjerni ne cdo rast per garantimin e produkteve tona.
10. Shoqeria Euro Mega 2010 sh.p.k ka kapacitetet financiare dhe ato profesionale perfshire edhe fuqine punetore per realizimin me sukses te objektit te prokurimit cdo kohe, ka nje fuqi punotore prej me shume se 20 persona, kriter i plotesuar per fuqine puntore. Përgjigjemi për porosi në sasi të mëdhaja në cdo kohë, pasi stafi jonë është mëse i mjaftueshëm. Xhiro vjetore e tre viteve e dorezuar ne oferten tone permbush kriterin financiar dhe kriterin profesional, ku nuk ka asnjë frikë për mosrealizim . Jemi ne treg prej shume vitesh dhe duke realizuar shume tendera dhe kontrata me insitucione shteterore dhe jo shteterore ne fushen e pastrimit.
11. Gjate viteve shoqeria "Euro Mega 2010" shpk ka fituar dhe realizuar me sukses nje numer te konsiderueshem kontratash shteterore me objekt furnizimin e materiale te pastrimit dhe detergjenteve, madje me vlere te fituara prej me shume se 50 % ulje cmimi:
12. Shoqeria "Euro Mega 2010" shpk ka realizuar me sukses kontrata te lidhura me subjekte shteterore si: Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, Marreveshje kuader

ku jo te gjitha kushtet jane të percaktuara, Loti I Nr kontrate 13/13 date 05/06/2019 m Agjencia e Blerjeve te Perqendruara, Marreveshje kuader ku jo te gjitha kushtet jane te percaktuara, Loti II Nr kontrate 13/14 date 05/06/2019 me vlere 66,464,429 pa tvshe vlere 41,867,014 pa tvsh.

13. Shoqeria "Trajtim Studenti Nr. 2" me nr.kontrate 116/7 date 31.05.2016 me vlere 1,200,000 leke me TVSH; "Bashkia Kruje me nr.kontrate 4841 prot date 15.11.2016 me vlere 1,548,000 leke me TVSH; "Bashkia Lezhe me nr.kontrate 27/1 prot. date 07.03.2017 me vlere 951,672 leke me TVSH ; "Bashkia Shkoder, Drejtoria Ekonomike e Arsimit" me nr.kontrate 92 prot. me vlere totale te kontrates 2,034,012 leke me TVSH; "Bashkia Shkoder Drejtoria e Cerdheve dhe Kopshteve" me nr.kontrate 29 prot. date 10.11.2016 me vlere 554,404 leke me TVSH ; "Ujesjelles-Kanalizime sh.a Rrogozhine" me nr.kontrate 40 prot. date 25.10.2017 me vlere 708,000 leke me TVSH; "Spitali Rajonal Pier" date 07.03.2017 me vlere 642,000 leke me TVSH; "Bashkia Lezhe" me nr kontrate 7860/2 prot. date 30.10.2016 me vlere 1,554,270 leke me TVSH si dhe shtesen e kontrates me nr. 319/1 prot. Date 30.01.2017 me vlere 310,854 leke me TVSH ; "Universiteti i Tiranes" me nr.kontrate 3665/9 date 07.12.2016 me vlere 4,980,000 leke me TVSH; "Bashkia Durres Shtepia e Foshnjes" me nr.kontrate 293 prot.date 15.03.2016 me vleren 510,000 leke me TVSH ; "Bashkia Kukes" me nr.kontrate 1144 prot. me vlere 2,147,940 leke me TVSH dhe shume prokurime te tjera nen vleren 800,000 leke vertetuar kjo me fatura tatimore si dhe transaksionet ne thesar.

"Universiteti i Tiranes" me nr.kontrate 3665/9 date 07.12.2016 eshte nje nga kontratat te cilen e kemi fituar ne baze te ofertes me te ulet edhe pas shpjegimeve dhe argumentimeve te ofertes sone e cila rezultoje anomalisht e ulet e kemi fituar me vlere 4,150,000 pa TVSH dhe e kemi realizuar me sukses. Fondi limit i procedures ishte 7,046,240 (shtate milion e dyzet e gjashtemije e dyqind e dyzet) leke (pa TVSH).

Bashkia Himarë e vitit 2020 e realizuar me sukses me vlert: 3,418,860 leke me tvsh .Bashkia Kruje e vitit 2020 e realizuar me sukses me vlerf 456,030 me tvsh, Bashkia KukEs vitit 2020 e realizuar me sukses me vlerE 2,257,440 leke me tvsh, Bashkia Shkoder e realizuar me sukses me vlere 682,740 me tvsh , Bashkia Kruje e vitit 2019 e ralizuar me sukses me vlere 1,176,000 leke me tvsh , Bashkia Lezhe e vitit 2019 e realizuar me sukses me vlere 772,920 leke me tvsh. Instituti i Femijeve qe nuk degjojne e realizuar me sukses me vlere 477,660 leke me tvsh.

-Bashkia Durres e vitit 2017 me nr kontrate 12675 date 23/06/2017 me vertetim realizimi me vlere 5, 759,304 leke me tvsh.

-Bashkia Durres e vitit 2019 me vlere 6,100,000 leke pa tvsh e cila eshte realizuar me sukses.

-Univeristeti Bujqesor i Tiranes nr kontrate 697/13 date 27/08/2018 vertetim realizim kontrate me vlere 927,648 leke me tvsh.

Bashkia Tirane nr kontrate 31914/7 date 05/10/2018 me vertetim realizim kontrate me vlere 1,176,036 leke me tvsh, Bashkia Rrogozhine me nr kontrate 328/1 date 30/01/2020 me realizim kontrate me vlere 1,164,600 leke me tvsh. Gjithashtu Proceduren e prokurimit Negocim pa shpallje te realizuar nga DREJTORIA E PERGLITHSHME E BURGJEVE , institucion ne varesi te institucionit tuaj e kemi realizuar me sukses pas sqarimit te ofertes sone e cila rezultoi anomalisht e ulet: "Blerje materiale pastrimi" dhe fond limit : 3.761.158 (Tre milion e shtateqind e gjashtedhete e nje mije e njeqind e pesedhete e tete)lek. Te cilen e realizuam me vleren 1.770.000 leke pa TVSH. Realizimi i kesaj kontrate u realizua ne kohe rekord sipas kerkesave te autoritetit kontraktor. E vertetueshme me vertetimin dhe kontraten e realizuar me Autoritetin Kontraktor ne fjale. Bashkia Maliq se fundmi me vlere 1, 785,600 leke te reja me tvsh.

Bashkia Shkoder me vlere 1,672,800 te reja me tvsh date 22.04.2021 (fatura elektronike), Drejtoria e Policise Tirane me vlere 552,000 leke te reja me tvsh date 16.03.2021 (fatura elektronike), Qendra Spitalore Universitare "Nene Tereza "me vlere 4,250,400 leke te reja date 23.03.2021 (fatura elektronike), Spitali Gjinekologjik "Mbretresha Geraldine" Loti I date 24.02.2021 me vlere 306,564 me tvsh (fatura elektronike), Spitali Gjinekologjik "Mbretresha Geraldine" Loti II date 24.02.2021 me vlere 1,201,434 me tvsh (fatura elektronike), Spitali Rajonal Elbasan "Xhaferr Kongoli" 543,720 leke me tvsh(fatura elektronike), S.U "Koco Gliozheni" Loti I me vlere 687,180 me tvsh date 15.04.2021 , S.U "Koco Gliozheni "Loti II me vlere 328,735 me tvsh date 15.04.2021 (fatura elektronike). Si dhe shume kontrata te tjera te realizuara me suksese ne vite, te cilat i kemi paraqitur dhe ngarkuar dhe ne sistemin SPE.

14. Materialet objekt prokurimi te cilat nuk prodhohen nga ne, shoqeria do ti siguroje tek kompani te cilat merren me tregeti me shumice dhe qe na sigurojne cmime konkurruese pasi jane dora e pare direkt pas imortit.
15. (Bashkangjitur fatura tatimore)
16. Bashkangjitur te gjitha faturat tatimore qe provojne cmimet me te cilat ne mund te prodhojme ose te blejme produktet sipas ofertes sone
17. Bashkangjitur lista e cmimeve me te cilat ne operojme ne treg.
18. Po ju paraqesim inventarin e produkteve qe kemi deklaruar ne Tatime dek.larimI fundit Janar 2021.
19. Me poshte po ju paraqesim ne menyre te detajuar secilin prej elementeve qe sherbejne per ndertimin e ofertes ekonomike (kartela e produktit) te cilat jane sekret tregtar por per te nxjerr koston e produktit do te duhet tjua paraqesim, duke arsyetura keshtu pse produktet tona jane me kete cmime dhe nuk mund ti fryjme cmimet duke abuzuar pasi prioriteti jone eshte cilesi dhe cmim i mire ne treg.
20. Baza materiale
Baza materiale per realizimin e produktit perfundimtar eshte lenda e pare, shishe plastike, tapa, etikete dhe kuti kartoni. Per secilin prej elementeve te hazes ju kemi

bashkangjitur faturat tatimore dhe proformat e lendes se pare me Kompani te lendes se pare brenda dhe jashte territorit Shqiptar.

- 21. Ju kemi dhene informacion te gjere me fatura bashkangjitur te lendes se pare , te bidonave plastik , etiketat, si dhe kutit e kartonit ku dhe mund te perlllogarisni sa del kostua e secilit produkt dhe gjithashtu bashkangjitur fatura tatimore te shitjes se produkteve tona dhe fatura tatimore te tenderave te ndryshme me cmimet qe ne I kemi realizuar me sukses.*
- 22. Shoqeria "Euro Mega 2010" shpk zbaton te gjitha detyrimet ligjore qe lidhen me mbrojtjen ne pune dhe kushtet e punes, ne vendin ku do te sigurohet furnizimi.*

Gjendja e lëndës se p are se fabikes me kodin LP) te prodhimit te detergjenteve "Euro mega 2010" e cila eshte e deklaruar te Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve e fundit e deklaruar ne Drejtorine e Tatimeve Janar 2021.

Ne baze te karteles se produktit per secilin artikull bashkengjitur nxjerrim cmimin per cdo produkt, Tabela perfshin te gjithe bazen material per realizimin e cdo produkti duke filluar qe nga lenda e pare deri tek amballazhi. Cmimet e meposhtme do te vertetohen nga faturat tatimore te bashkangjitura me kete deklarate.

Ne baze te ketyre cmimeve , qe ne rast se jane me shumice ne ofrojme cmime tjetere me te ulet, qe ne kemi deklaruar ne drejtorine e Pergjithshme te Tatimeve ne nuk mund te abuzojme dhe te rrisim cmimet ne menyre absurde per te formuluar fonnularin e ofertes te autoritetit tuaj kontraktor. Nuk e di cilin treg keni studiuar sepse cmimet me te cilat ju e keni perlllogaritur fondin limit nuk jane egzistente ne Shqiperi.

çmimet e ofertes sone jane te justifikuara me ane te faturave te rregullta tatimore dhe kartela teknike te secilit produkt qe nga perpunimi deri tek shitja. Po ju paraqesim dhe bashkelidhur gjithashtu kartelat e produkteve qe shoqeria jone prodhon ku tregohen te gjitha holltesite se sa del kostua e ketyre produkteve: Nuk ka sens qe nje operator ekonomik, aq me teper Kompani prodhuese te o:froj nje cmim qe nuk e perballon dot ose per me teper te humbas fitimin e vet duke realizuar proceduren tuaj, qe do te thote ne e perballojme realizimin e procedures me cmimet qe ne kemi ofertuar. Perderisa ne kemi dhene kete oferte, deklarojme se do t'i permbusim iibrkesat e institucionit tuaj pa ndikuar ne cilesine e produkteve pasi një gje e tille pervec humbjeve sjell edhe prishjen e imazhit te kompanise sonë, ne jemi një kompani qe synojme te rritemi cdo dite duke investuar ne imazhin tone dhe jo ne prishjen e tij.[...]

Bashkelidhur do të gjeni:

lista e çimeve të shitjes

magazina e mallrave

dokumenti "material safety datasheet" (53fletë)

shkresë nr. 1925/1prot datë 09.04.2021 lëshuar nga ISHTI.

Raport analizimi NR-D-10 nr. 10/1prot datë 09.04.2021 lëshuar nga ISHTI.

Raport analizimi NR-D-11 nr. 11/1prot datë 09.04.2021 lëshuar nga ISHTI.

Raport analizimi NR-D-12 nr. 12/1prot datë 09.04.2021 lëshuar nga ISHTI.

Raport analizimi NR-D-13 nr. 13/1prot datë 09.04.2021 lëshuar nga ISHTI.

Raport analizimi NR-D-14 nr. 14/1prot datë 09.04.2021 lëshuar nga ISHTI.

Raport analizimi NR-D-15nr. 15/1prot datë 09.04.2021 lëshuar nga ISHTI.

Raport analizimi NR-D-16 nr. 16/1prot datë 09.04.2021 lëshuar nga ISHTI.

Raport analizimi NR-D-17 nr. 17/1prot datë 09.04.2021 lëshuar nga ISHTI.

Raport analizë data e raportimit 15.12.2020.

çertifikatë regjistrimi marke

çertifikatë regjistrimi marke nr. 780/4prot datë 28.10.2015

shkresë nr. 10 datë 19.01.2021

dokumenti “vendodhja e ushtrimit të veprimtarisë” (EURO Mega 2010 shpk, Prodhimi i kimikateve organike bazë)

dokumenti “Njoftimet” (EURO Mega 2010 shpk, Prodhimi i kimikateve organike bazë)

dokumenti “ shkarkimet” (EURO Mega 2010 shpk, Prodhimi i kimikateve organike bazë)

dokumenti “Inspektime vizuale” (EURO Mega 2010 shpk, Prodhimi i kimikateve organike bazë)

dokumenti “Menaxhimi i mbjetjeve” ” (EURO Mega 2010 shpk, Prodhimi i kimikateve organike bazë)

dokumenti “zhurmat dhe vibracioni” EURO Mega 2010 shpk, Prodhimi i kimikateve organike bazë)

dokumenti “dokumentimi dhe Raportimi” (EURO Mega 2010 shpk, Prodhimi i kimikateve organike bazë)

dokumenti “Raporti i rezultateve” (përqëndrimi total i lëndës së grimcuar në suspension (LNP) në ajër.

dokumenti “Raporti i rezultateve” (Përqëndrimi total i gazeve)

dokumenti (Raport i rezultatit të matjes së nivelit të zhurmës).

shkresa nr. 115prot. datë 26.04.2021 lëshuar nga Agjencia Kombëtare e Mjedisit.

dokumenti “relacion shkencor periodik vetmonitorimi” EURO Mega 2010 shpk, Prodhimi i kimikateve organike bazë)

raport i provave nr. 3310 datë 16.01.2021

raport i rezultateve nr. 2474

raport i rezultateve nr. 2094

raport i rezultateve nr. 2567

proforma invoice datë 24.05.2019

proforma invoice datë 27.05.2019

proforma invoice datë 16.07.2020

proforma invoice datë 25.04.2019

import export invoice no GSH2018ALB02 datë 01.04.2018

commercial invoice no GSH2018ALB03 datë 31.03.2018

proforma invoice datë 23.12.2019

proforma invoice datë12.03.2020

proforma invoice datë 27.04.2017

proforma invoice datë 21.10.2020

proforma invoice datë 15.07.2020

proforma invoice datë 08.12.2020

proforma invoice datë 08.06.2020

proforma invoice datë 10.04.2020

proforma invoice datë 15.10.2020

proforma invoice datë 28.04.2021

proforma invoice datë 06.01.2021
proforma invoice datë 16.04.2021
proforma invoice datë 06.01.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 46 datë 30.03.2018
faturë nr. 46
faturë tatimore shitjeje nr. 1 datë 22.05.2018
faturë tatimore shitjeje nr. 4 datë 31.05.2018
faturë tatimore shitjeje nr. 1 datë 03.01.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 116 datë 24.01.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 43 datë 02.02.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 38 datë 04.02.2019
faturë nr. 38
faturë tatimore shitjeje nr. 55 datë 13.02.2019
faturë tatimore shitjeje nr.69 datë 26.02.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 123 datë 07.03.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 112 datë 21.03.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 127 datë 28.03.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 137 datë 29.03.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 125 datë 30.03.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 128 datë 15.04.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 26 datë 03.05.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 133 datë 11.05.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 134 datë 18.05.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 56 datë 04.12.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 130 datë 28.05.2019
faturë tatimore shitjeje nr.76 datë 31.05.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 119 datë 29.06.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 02 datë 04.07.2019
faturë nr. 02
faturë tatimore shitjeje nr. 14 datë 17.07.2019
faturë nr. 14
faturë tatimore shitjeje nr. 15 datë 23.07.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 152 datë 26.07.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 03 datë 31.07.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 166 datë 01.08.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 150 datë 29.08.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 223 datë 29.08.2019
faturë tatimore shitjeje nr.229 datë 31.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 230 datë 21.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. ____ datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 239 datë 03.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 240 datë 04.09.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 23 datë 20.09.2019
faturë nr. 23

faturë tatimore shitjeje nr. 281 datë 30.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 290 datë 01.12.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 567 datë 27.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 30 datë 28.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 31 datë 30.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 362 datë 04.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 359 datë 04.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 407 datë 03.12.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 408 datë 03.12.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 421 datë 09.12.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 459 datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 23 datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 35 datë 30.01.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 10 datë 20.01.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 11 datë 27.01.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 41 datë 01.02.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 46 datë 04.02.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 47 datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 114 datë 20.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 70 datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 114 datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 82 datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 19 datë 02.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 96 datë 02.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 114 datë 11.03.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 273 datë 13.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 128 datë 13.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. ____ datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 153 datë 25.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 26 datë 28.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 156 datë 26.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 284 datë 28.09.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 27 datë 30.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 276 datë 30.02.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 166 datë 31.03.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 180 datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 186 datë 10.01.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 292 datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 196 datë 23.04.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 208 datë 01.05.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 221 datë 15.05.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 352 datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. ____ datë ____
faturë tatimore shitjeje nr. 250 datë 28.05.2020

faturë tatimore shitjeje nr. 294 datë 23.06.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 299 datë 26.06.2020
faturë tatimore shitjeje nr. ____--__ datë _____
faturë tatimore shitjeje nr. 290 datë 02.07.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 53 datë 02.07.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 362 datë 01.08.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 187 datë _____
faturë tatimore shitjeje nr. 406 datë _____
faturë tatimore shitjeje nr. 405 datë 01.09.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 448 datë _____
faturë elektronike numri i faturës 12/2021
faturë elektronike numri i faturës 1/2021
faturë elektronike numri i faturës 14/2021
faturë elektronike numri i faturës 13/2021
faturë elektronike numri i faturës 8/2021
faturë elektronike numri i faturës 2/2021
faturë elektronike numri i faturës 18/2021
faturë elektronike numri i faturës 6/2021
faturë elektronike numri i faturës 11/2021
faturë elektronike numri i faturës 7/2021
faturë elektronike numri i faturës 10/2021
faturë elektronike numri i faturës 17/2021
faturë tatimore shitjeje nr. 27 datë 11.06.2020
faturë nr. 27
faturë tatimore shitjeje nr. 24 datë 01.06.2020
faturë nr. 24
faturë tatimore shitjeje nr. 378 datë 30.06.2021
faturë tatimore shitjeje nr. 1018 datë 30.06.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 93 datë 27.06.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 514 datë 26.06.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 180 datë 28.06.2020
faturë tatimore shitjeje nr. 6 datë 15.01.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 547 datë 19.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 2741 datë 27.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 560 datë 27.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 31 datë 30.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 1435 datë 30.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 33 datë 08.11.2019
faturë nr. 74190583
faturë tatimore shitjeje nr. 34 datë 08.11.2019
faturë numër 74190584
faturë tatimore shitjeje nr. 35 datë _____.11.2019
faturë numër 35
faturë tatimore shitjeje nr. 36 datë 12.11.2019

faturë nr. 36
faturë tatimore shitjeje nr. 37 datë 22.11.2019
faturë nr. 37
faturë tatimore shitjeje nr. 272 datë 21.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 274 datë 25.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 352 datë 01.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 353 datë 01.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 357 datë 02.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 360 datë 04.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 367 datë 09.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 377 datë 14.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 378 datë 14.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 382 datë 16.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 394 datë 20.11.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 7 datë 18.12.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 422 datë 09.12.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 423 datë 09.12.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 614 datë 01.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 626 datë 07.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 2035 datë 16.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 279 datë 24.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 1566 datë 25.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 7194 datë 30.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 25 datë 14.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 28 datë 28.10.2019
faturë nr. 28 datë __.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 300 datë 08.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 302 datë 08.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 303 datë 08.10.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 554 datë 04.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 427 datë 11.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 432 datë 14.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 1124 datë 23.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 607 datë 26.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 1145 datë 26.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 22 datë 05.09.2019
faturë tatimore shitjeje nr. 24 datë 30.09.2019
faturë nr. 24
faturë tatimore shitjeje nr. 232 datë 02.09.2019

III.3.5. Nga interpretimi literal i nenit 56 pika 1 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se barra e provës mbi argumentin e ofertës anomalisht të ulët i përket operatorit ekonomik, oferta e të cilit është konstatuar nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave dhe në zbatim të VKM 914/2014. Gjithashtu, K.P.P. gjykon se

argumentimi i ofertës anomalisht të ulët njëherazi duhet të plotësojë katër kushte kumulative për ti dhënë garanci si edhe bindje autoritetit kontraktor. Së pari, operatori ekonomik duhet të dorëzojë në mënyrë të detajuar anën ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara, gjithashtu duhet të paraqesë para autoritetit kontraktor zgjidhjet teknike të ofruara si edhe në raste të veçanta dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve. Gjithashtu është detyrë e operatorëve ekonomikë oferta e të cilëve është konstatuar anomalisht e ulët të paraqesin prova shkresore para autoritetit kontraktor në lidhje me origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi, si edhe së fundmi duhet të vërtetojë zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi. K.P.P. gjykon se katër kushtet e mësipërme të parashikuara nga lex specialis janë kushte kumulative të cilat më anë të provave shkresore dhe argumentimeve përkatëse duhen plotësuar nga operatorët ekonomikë ankimes, oferta e të cilëve rezultojnë anomalisht e ulët. Referuar nenit 56 pika 2 të LPP-së autoriteti kontraktor i verifikon këto elemente duke u këshilluar me ofertuesin dhe në bazë të informacionit të paraqitur. Autoriteti kontraktor mund ta refuzojë ofertën, kur edhe pas shqyrtimit të informacionit të paraqitur nga ofertuesi, nuk bindet se ajo është e rregullt në të gjitha elementet e saj. K.P.P. gjykon se nga interpretimi teleologjik i normës së mësipërme (qëllimi i saj) lidhet drejtpërdrejtë me shmangien e riksut që mund të sjellë një ofertë e cila rezultojnë anomalisht e ulët. K.P.P. gjykon se risku që shfaqet në rast se një ofertë rezultojnë anomalisht e ulët është në disa drejtime ku ndër të tjera si: rreziku për moskryerjen e shërbimit/punëve në cilësinë e duhur; rreziku i tërheqjes së operatorit ekonomik nga lidhja e kontratës dhe kosto që i lindin autoritetit nga moskryerja e shërbimit brenda afateve kohore të parashikuara; humbjet që mund të pësojë në kohë nga mos kryerja e shërbimit gjatë periudhës së ripublikimit të procedurës së tenderit në rast të mos zbatimit të kontratës nga ana e operatorit 10 ekonomik oferta e të cilit rezultojnë anomalisht e ulët. Gjithashtu, K.P.P. thekson se referuar nenit 1 gërma “b” “Objekti dhe qëllimi” i ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar parashikohet se “Objekt i këtij ligji është përcaktimi i rregullave që zbatohen për prokurimet e mallrave, të punëve dhe të shërbimeve nga autoritetet kontraktore të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale; Mirëpërdorimi i fondeve publike përfshin jo vetëm përzgjedhjen nga autoriteti kontraktor të ofertave më të ulëta (si kriter i përzgjedhjes së ofertës fituese referuar “çmimit më të ulët”), por gjithashtu shmangien e risqeve dhe dështimin e kontratës që mund të vijjë nga oferta të cilësuar si anomalisht të ulëta, referuar formulës së përlllogaritjes të parashikuar në ligj.

III.3.6. Nga shqyrtimi i dokumentacionit të dorëzuar para autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik, KPP gjykon se nga ana e operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK në përmbushje të parashikimeve të nenit 56 të ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik” të ndryshuar, janë dorëzuar pranë autoritetit kontraktor përshkrime narrative si edhe dokumentacion shoqërues dhe provues mbi argumentimin ligjor, teknik dhe ekonomik të ofertës së dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike, për procedurën e prokurimit objekt ankimi. Konkretisht, në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “a” të ligjit nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të *anës ekonomike të metodës së ndërtimit, procesit të prodhimit ose të shërbimeve të ofruara*, si një prej 4 kushteve kumulative, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK ka dorëzuar një përshkrim të produktit të ofruar duke bashkëngjitur listën e produkteve që

disponon/tregton e firmosur dhe vulosur, skeda teknike të sigurisë të produkteve të prodhuara si dhe tabelën e kostove përkatëse të produkteve në të cilën ka përshkruar elementët për prodhimin e produktit etj. Në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “b” të ligjit nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të *zgjidhjet teknike të ofruara dhe/ose ndonjë kusht favorizues të jashtëzakonshëm, që ka ofertuesi për kryerjen e punimeve, për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve*; si një prej 4 kushteve kumulative, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK ka dorëzuar fatura tatimore të blerjes së mallrave (lëndës së parë) të nevojshme për prodhimin e produktit final në të cilën deklarohen çmime për njësi, të cilat parë me sasinë e kërkuar për prodhimin e produktit objekt prokurimi çmimi për sasi sipas listës së përbërësve të deklaruar nga ana e ankimuesit është e një çmimi më të ulët nga ajo e blerjes së lëndës së parë. Akoma më tej, KPP konstaton se operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK njëherazi ka provuar para autoritetit kontraktor eskperencën e tij të ngjashme në lidhje me furnizimin dhe përmbushjen me sukses të kontratave për furnizimin me mallra objekt prokurimi me të njëjtin autoriteti kontraktor si edhe autoritete të tjera kontraktore. Në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “c” të ligjit nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të *origjinalitetin e punëve, mallrave apo të shërbimeve, të propozuara nga ofertuesi* si një prej 4 kushteve kumulative, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK ka dorëzuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike dëshmi se shfaqet në cilësinë e prodhuesit të mallrave objekt prokurimi dhe se kostoja e llogaritur mbi njësinë e kërkuar është llogaritur në cilësinë e prodhuesit duke shfaqur garanci mbi origjinalitetin e mallrave objekt prokurimi. Në lidhje me parashikimet e nenit 56 pika 1 gërma “ç” të ligjit nr.9643/2006 në drejtim të argumentimit të *zbatueshmërinë e detyrimeve, që lidhen me mbrojtjen në punë dhe kushtet e punës, në vendin ku do të kryhet puna, shërbimi apo ku do të sigurohet furnizimi* KPP konstaton se me anë të dokumentacionit të dorëzuar në mbështetje të ofertës anomalisht të ulët, operatori ekonomik “Euro Mega 2010” ShPK ka dorëzuar ndër te tjera dokumentacion mbi qendrën e monitorimit të mjedisit, në këtë dokument (relacion shkencor periodik vetmonitorimi), ka parashikuar vendodhjen e fabrikës, aktivitetin prodhues shkarkimet e aktivitetit (shkarkime të lëngëta të gazta dhe të ngrurta), nivelin e aspirimit të repartit të prodhimit edhe të dhëna mbi nivelin e zhurmës.....etj. Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se me anë të dokumentacionit të dorëzuar ankimues përmbush katër kushtet kumulative të kërkuar nga ligji i posaçëm në drejtim të argumentimit të ofertës ekonomike anomalisht të ulët. Është detyrim i operatorëve ekonomikë që në rast të shpalljes fitues t’i përmbahen zbatimit të kontratës duke ofruar shërbime/punë/mallra me të njëjtin cilësi të kërkuara në dokumentet e procedurës së prokurimit dhe me të njëjtën ofertë ekonomike të propozuar. Akoma më tej, Komisioni i Prokurimit Publik sqaron se në bazë të nenit 62 “Detyrimet gjatë zbatimit të kontratës” të LPP, autoriteti kontraktor ka një rol të posaçëm, për vetë cilësimin e tij ligjor, si autoriteti me interes dhe përgjegjësi thelbësore për realizimin e suksesshëm të kontratës. KPP sjell në vëmendje se, referuar rregullave të prokurimit publik, është pikërisht autoriteti kontraktor ai që duhet të monitorojë zbatimin e kontratës, për t’u siguruar nëse cilësia e mallit do të jetë e njëjtë me cilësinë dhe specifikimet teknike të premtuar në ofertë dhe të përcaktuar në kontratë. Në rast të shkeljes së kushteve të kërkuara, autoriteti kontraktor zbaton penaltitetet e parashikuara në kontratë, apo detyrimet, në mbështetje të nenin 62 të LPP-së, si më sipër cituar.

Sa më sipër pretendimi i palës ankimuese nuk qëndron.

Për sa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 31 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 596/2018, datë 12.09.2018 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të mos pranojë ankesën e operatorit ekonomik “Pastrime Silvio” ShPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur”, me nr. REF-90596-03-19-2021, me objekt: Loti I “Blerje detergjent, dizifektant dhe aromatizues”, me fond limit 125,924,225.74 lekë pa tvsh, zhvilluar në datën 15.04.2021 nga autoriteti kontraktor, Agjencia e Blerjeve të Përqendruara.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit të sipërcituar.
3. Kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë, Tiranë.
4. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 978Protokolli

Datë 03.06.2021

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri